

**GJENDJA ME GRIPIN/SËMUNDJET E NGJASHME ME GRIPIN
SEZONI 2024/2025
-Informacioni përmbyllës-**

**Departamenti i epidemiologjisë së sëmundjeve infektive
Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut**

PËRMBAJTJA

TË DHËNA JAVORE	Error! Bookmark not defined.
<i>Mbikëqyrja epidemiologjike</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Mbikëqyrja sentinel ndaj SARI</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Mbikëqyrja virologjike (mbikëqyrja rutinore+SARI).....</i>	<i>4</i>
КУМУЛАТИВНИ ПОДАТОЦИ ЗА СЕЗОНА 2024-2025.....	Error! Bookmark not defined.
<i>Mbikëqyrja epidemiologjike</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Shpërndarja gjeografike.....	Error! Bookmark not defined.
Shpërndarja sipas moshës	Error! Bookmark not defined.
Shpërndarja sipas javëve	Error! Bookmark not defined.
Mortaliteti si pasojë e gripit	Error! Bookmark not defined.
<i>Mbikëqyrja sentinel ndaj SARI (Infeksione respiratore akute serioze)</i>	<i>7</i>
<i>Mbikëqyrja virologjike (mbikëqyrja rutinore+SARI).....</i>	<i>9</i>
KOMENT EPIDEMIOLOGJIK	Error! Bookmark not defined.
MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM	Error! Bookmark not defined.
Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripi?	Error! Bookmark not defined.
VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT	Error! Bookmark not defined.
RAJONI EVROPIAN	Error! Bookmark not defined.

TË DHËNA JAVORE


Mbikëqyrja epidemiologjike

Gjatë **javës së njëzetë** të vitit 2025 (nga 12-18.05.2025) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar **35 (I=1,9/100.000)** raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 30,0% më pak se javën e kaluar.

Krahasuar me javën e katërmëdhjetë të vitit të kaluar (n=60) numri është për 41,7% më i vogël, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (n=30) është regjistruar një rritje prej 17,6%.

Incidenca e raportuar korrespondon me aktivitet jashtësezonal të virusit të gripit (Grafiku 1).

Grafiku 1. *Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025*



Sa i përket shpërndarjes sipas moshës 27 raste janë regjistruar tek grupmosha 15-64 vjet dhe 8 tek personat mbi 65 vjet. Incidencë më e lartë (2,5/100.000) është regjistruar tek personat mbi 65 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në 5 QSHP/NJR : Gostivar – 18, Tetovë – 7, Shkup – 6, ndërsa në Ohër dhe në Makedonski Brod janë regjistruar nga 2 raste.

Gjatë kësaj jave nuk janë regjistruar raste të vdekjes si pasojë e gripit.

Mbikëqyrja sentinel ndaj SARI

Nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, gjatë javës së njëzetë janë raportuar gjithsej 17 raste me SARI nga vendet sentinel SARI në Shkup (pa KU të Sëmundjeve Infektive dhe Gjendjeve Febrile) dhe Shtip. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=10; 62,5%) janë raportuar nga KU për Sëmundje Respiratore të Fëmijëve - Kozle.

Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=11;) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Këtë javë numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 172, asnjë person nuk është i shtruar në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet 9,9% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë është regjistruar tek fëmijët nga 0-4 vjet.

Mbikëqyrja virologjike (mbikëqyrja rutinore+SARI)

Në javën e njëzetë të raportimit, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 14 materiale nga mbikëqyrja rutinore (5) dhe sentinel SARI (9) nga institucionet shëndetësore paralelisht të testuara për Influenza dhe SARS-CoV-2.

Nuk janë regjistruar rezultate pozitive me grip.

Nuk janë testuar mostra për virus sincial respirator (RSV).

TË DHËNA KUMULATIVE PËR SEZONIN 2024/2025

Mbikëqyrja epidemiologjike

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është **26.040 (I=1.417,8/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=15.171), numri i rasteve të regjistruara ka shënuar një rritje prej 71,6%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit (n=20.990) është regjistruar një rritje prej 24,1%.


Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 29 QSHP/NJR.

Shpërndarja gjeografike

Numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar në Shkup, (n=7.030; 27,0%), Kumanovë (n=2.243; 8,6%), Manastir (n=1.796; 6,9%), Strumicë (n=1.776; 6,8%), Tetovë (n=1.573; 6,0%), Kavadar (n=1.546; 5,9%), Gostivar (n=1.334; 5,1%), Shtip (n=1.167; 4,5%) dhe Dibër (n=1.062; 4,1%) (Grafiku 2) (Tabela 1).

Incidenca më e lartë kumulative prej 5.550,9/100.000 banorë është regjistruar në Dibër. Incidenca më e lartë se 2.000,0/100.000 banorë është regjistruar në Kratovë, Sveti Nikole, Kavadar, Prespë, Radovish, Shtip dhe Strumicë (Grafiku 2) (Tabela 1).


Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve me grip sezonal sipas QSHP/NJR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2024/2025



Shpërndarja sipas moshës


Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) – 14.958 raste (57,4%), ndërsa incidencë më e lartë (3.099,8/100.000) tek fëmijët e moshës 0-4 vjet (n=2.992).

Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve me grip sezonal dhe incidenca në 100.000 banorë sipas moshës, sezoni 2024/2025



Nëse analizohet numri i personave të sëmurë sipas javëve vihat re se në pjesën më të madhe të sezonit dominojnë rastet tek grupmoshat e reja, fëmijët nga 0-4 vjet dhe 5-14 vjet. (Grafiku 4)

Grafiku 4. Shpërndarja javore e rasteve me grip sezonal sipas grupmoshave – incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2024/2025




Shpërndarja kohore

Ky sezon karakterizohet me një numër më të madh të të sëmurëve krahasuar me modelin katermbëdhjetë vjeçar. Numri i rasteve të regjistruara me grip/sëmundje të ngjashme me gripin arriti kulminacion në javën e pestë të vitit 2025 (n=3.036), dy javë më herët nga ajo që pritej sipas modelit MEM.

Analiza e numrit të të sëmurëve me grip sezonal sipas muajve tregon për një rritje graduale të numrit të të sëmurëve dhe arritje të kulminacionit në muajin shkurt të vitit 2025 (n=11.210).

Nga numri i përgjithshëm i personave të sëmurë në sezonin 2024/2025, gjatë vitit 2024 janë regjistruar 1.024 pserona ose 3,9%. Të tjerët 96,1% ose 25.016 persona janë regjistruar në vitin 2025.

Grafiku 5. Shpërndarja e rasteve me grip sezonal sipas muajve, sezoni 2024/2025



Mortaliteti si pasojë e gripit

Gjatë sezonit 2024/25 janë regjistruar 5 raste të vdekjes si pasojë e gripit.

Të ndjerët janë nga Shkupi (n=3), Sveti Nikole (n=1) dhe Radovishi (n=1) dhe bëjnë pjesë në grupmoshën mbi 65 vjet (n=4) dhe 15-64 vjet (n=1).

Të gjitha rastet e vdekjes kanë ndodhur në kushte spitalore, me komorbiditete dhe kanë qenë të pavaksinuar kundër gripit sezonal.

Tek dy persona është vërtetuar Influenza A(H1)pdm09, tek dy – Influenza AH3 dhe tek një është vërtetuar Influenza A – e pasubtipizuar.


Mbikëqyrja sentinel ndaj SARI (Infeksione respiratore akute serioze)

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si mbikëqyrje shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes së gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e që ka për qëllim fitimin e informacionit më të detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për zbatimin e masave parandaluese në kohë. Mbikëqyrja sentinel SARI kryhet në 6 spitale mbikëqyrëse, 5 në Shkup (KU e Sëmundjeve Infektive dhe Gjendjeve Febrile, KU për Sëmundjet e Fëmijëve, KU e Alergologjisë dhe Pulmologjisë, SPQ 8 Shtatori dhe KU për Sëmundje Respiratore tek Fëmijët - Kozle) në një në Shtip (SK Shtip). Definicioni për rastet SARI

sipas të cilit zbatohet mbikëqyrja është në përputhje me definicionin e rastit të dhënë nga OBSH-ja në vitin 2014.


Kumulativisht nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, janë raportuar gjithsej 1.275 raste me SARI, me 20 persona në kujdes intensiv. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=472; 37,8%) janë raportuar nga KU për Sëmundje tek Fëmijët. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=564; 50,1%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Grafiku 6. Shpërndarja javore e rasteve SARI sipas vendeve SARI, sezoni 2024/2025



Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=644; 51,5%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.


Grafiku 7. Shpërndarja e rasteve SARI sipas grupmoshave dhe vendeve SARI, sezoni 2024/2025



Kumulativisht, numri i përgjithshëm i pranimeve (hospitalizimeve) në vendet sentinel është 7.876. Nga të gjitha pranimet, 16,2% janë si pasojë e SARI, me ç'rast 20 persona janë raportuar në kujdes intensiv. Nëse analizohet ngarkesa sipas javëve, mund të vihet re se ngarkesë më e madhe me SARI, spitalet regjistrojnë në periudhën nga java e pestë deri në javën e nëntë të vitit 2025 kur kjo ngarkesë ka qenë nga 27,3%-35,2%. (Grafiku 8).

Ngarkesë më e lartë prej 20,0% është regjistruar tek personat e grupmoshës nga 0-4 vjet.

Grafiku 8. Ngarkesa me SARI nga numri i përgjithshëm i hospitalizimeve, sezoni 2024/2025



Gjatë sezonit 2024/2025 janë regjistruar 9 raste të vdekjes, 2 në moshë nga 30-64 dhe 7 mbi 65 vjet, të gjithë me komorbiditete dhe të pavaksinuar. Tek katër prej tyre është vërtetuar prani e virusit të Influenzës, dhe atë: 2 raste me Influenza A(H3), 1 me Influenza A(H1)pdm09 dhe 1 me Influenza A - e patipizuar.

Mbikëqyrja virologjike (mbikëqyrja rutinore+SARI)

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e njëzetë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 1.128 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Të gjitha materialet janë testuar edhe për prani të virusit të gripit, SARS-CoV-2 dhe / ose RSV. (Tabela 1, Grafiku 9)

Tabela 1. Shpërndarja, numri dhe përqindja e materialeve pozitive nga mbikëqyrja rutinore dhe sentinel sipas origjinës dhe numrit, RMV, 2024/2025


Lloji dhe nënloji i virusit	Origjina		Sezoni 2024/25	
	rutinor	Sentinel SARI	numri	%
Influenza A	87	86	173	60,5%
Influenza A/H1pdm	15	25	40	23,1%
Influenza A/H3	64	54	118	68,2%
Influenza A – e pasubtipizuar	8	7	14	8,7%
Influenza B	81	32	113	39,5%
Influenza B Victoria	80	32	112	99,1%
Influenza B – linjë e papërcaktuar	1	0	1	0,9%
SARS-CoV-2	6	4	10	-
RSV	15	91	106	-
RSV-A	9	62	71	67,0%
RSV-B	6	29	35	33,0%

Janë detektuar 286 raste pozitive me grip. (Tabela 1)

Janë regjistruar 10 raste pozitive me SARS-CoV-2 dhe 106 raste me RSV. (Tabela 1)

Tek tre persona është regjistruar koinfeksion i Influenza dhe RSV, tek një person koinfeksion i RSV dhe SARS-CoV-2 dhe tek dy persona koinfeksion i Influenza A dhe Influenza B.

Grafiku 9. Shpërndarja javore, numri dhe përqindja e mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja sentinel dhe rutinore, RMV, 2024/2025



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Sezoni 2024/2025 karakterizohet nga një numër më i lartë rastesh të raportuara dhe një incidencë më të lartë krahasuar me mesataren (modeli 14-vjeçar), si dhe një përqindje më të lartë të rasteve pozitive (23.3%) të numrit të përgjithshëm të personave të testuar krahasuar me sezonin e mëparshëm, i cili ndryshonte gjatë javëve me ndryshime midis mbikëqyrjes rutinore dhe mbikëqyrjes sentinel SARI.

Pragu për hyrjen në sezon (virologjik), d.m.th. përqindja e pozitivitetit të mostrave mbi 10%, është regjistruar nga java 52 e vitit 2024 deri në javën 12 të vitit 2025. Sipas të dhënave epidemiologjike aktiviteti sezonal është regjistruar nga java 4 deri në javën 10 të vitit 2025. Mospërputhja midis të dhënave virologjike dhe epidemiologjike, si dhe përqindja e lartë e pozitivitetit është ndoshta për shkak të numrit më të vogël të rasteve të testuara.

E përderisa në gjysmën e parë të sezonit dominon Influenza A, dominimi i virusit Influenza B është regjistruar në gjysmën e dytë të sezonit. Për sa i përket Influenza B, vetëm Influenza B/Victoria vazhdon të qarkullojë në vend. Për sa i përket Influenza A, këtë sezon Influenza AH3 është dominante në krahasim me sezonin e kaluar kur dominonte Influenza A(H1)pdm.

Sipas të dhënave nga mbikëqyrja SARI, numri i hospitalizimeve është në një nivel më të ulët krahasuar me sezonin e kaluar, por më i lartë se mesatarja e periudhës së mëparshme.

MASA TË PËRGJITHSHME PËR PARANDALIM

*Burimi : <https://sezonskigrip.mk/>

Masat e përgjithshme për mbrojtjen nga gripi kanë për qëllim mbrojtjen nga sëmundjet akute të frymëmarrjes dhe nga ato mund të ketë përfitime të mëdha, veçanërisht nëse zbatohen gjatë gjithë periudhës së dimrit:

- Shmangni mbledhjen dhe qëndrimin në dhoma ku qëndrojnë më shumë njerëz, veçanërisht shmangni kontaktin e ngushtë me njerëz të sëmurë ose të dyshimtë – me kollë, teshtimë, temperaturë të lartë të trupit.
- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë ose dezinfektues.
- Mjediset e banimit mbani të ngrohura dhe ajrosni ato shpesh.
- Vishuni me veshje të ngrohta me shtresa dhe larje me ujë të ngrohtë.
- Konsumoni pije të ngrohta (çaj dhe supë), lëngje frutash dhe ujë me limon.
- Hani produkte të freskëta të pasura me vitamina dhe minerale, më së miri fruta dhe perime që janë më të mira për trupin. Produktet e pasura me vitaminë C (limon, portokall) janë ato që rekomandohen më shumë. Nëse produktet ushqimore të freskëta nuk janë gjithmonë në dispozicion, mund të përdoren edhe pije dhe preparate me multivitamina.
- Bëni një stil jete dhe zakonesh të shëndetshme, pushoni dhe fleni irë, ushqehuni shëndetshëm, bëni aktivitetit fizik dhe ruajeni qetësinë mendore dhe reduktoni stresin.

Çfarë duhet të bëni nëse sëmureni nga gripi?

Ndiqui këto rekomandime:

- Qëndroni në shtëpi dhe mos shkoni në punë, shkollë apo vende ku ka shumë njerëz.
- Pushoni dhe konsumoni shumë lëngje dhe ushqime të lehta.
- Shmangni kontaktin e ngushtë me njerëzit me të cilët jetoni, mos pranoni vizitorë gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbuloni hundën dhe gojën me një fasuletë kur kolliteni dhe teshtini. Pas përdorimit, hidheni atë në koshin e plehrave.
- Mbani maskë mbrojtëse kur jeni në kontakt me të afërmit tuaj në shtëpi, kur kolliteni dhe teshtini.
- Praktikoni larjen e shpeshtë dhe të plotë të duarve me ujë të ngrohtë dhe sapun.
- Përdorni peceta të lagura që përmbajnë alkool ose dezinfektues duarsh.
- Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës me duar.
- Ajrosni shpesh dhomën në të cilën qëndroni gjatë kohës që jeni të sëmurë.
- Mbani mjedisin tuaj të pastër – gjësendet, sipërfaqet me produkte higjienike shtëpiake.
- Nëse jeni mbi 65 vjeç ose keni sëmundje kronike, ose nëse simptomat e sëmundjes përkeqësohen ose zgjasin për disa ditë - kërkonin ndihmë nga mjeku.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike

- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vakcinacija.mk.

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 70.376 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cënueshme të popullatës.

2.600 vaksina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vaksina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.923 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 72.300 persona me vaksina falas dhe komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Sipas raportit të ERVISS të publikuar për javën e 20 të vitit 2025 për aktivitetin e virusit të gripit në mbarë Rajonin evropian të OBSH-së:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute (IRA) është rritur mbi nivelet bazë në 1 nga 33 vende të rajonit evropian të OBSH-së.
- Sezoni i gripit 2024/2025 përfundoi, me çka numri më i madh i indikatorëve për aktivitetin e gripit vazhdojnë të bien në nivele messezionale.
- Numri i rasteve pozitive me RSV në mbikëqyrjen sentinel po zvogëlohet krahasuar me pikun që u arrit në fund të muajit dhjetor.
- Aktiviteti i SARS-CoV-2 shënon rritje në raport me përqindjes së rasteve pozitive në shëndetësinë primare dhe sekondare gjatë javëve të fundit, por numri i rasteve të regjistruara mbetet në nivel të ulët.

Nga 30 vende të cilat raportojnë për intensitetin e gripit: 2 kanë raportuar për intensitet mesatar dhe të lartë.

Nga 29 vende të cilat raportojnë për shpërndarjen gjeografike të gripit: 7 kanë raportuar për shpërndarje të rajonale ose të gjerë të virusit të gripit.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) më 28.02.2025 publikoi rekomandime për përbërjen virale të vaksinave të gripit për sezonin e gripit 2025/2026 në hemisferën veriore. Njoftimi u bë në një sesion informativ me qëllim vlerësimin e të dhënave mbi viruset që qarkullojnë dhe, si përfundim, jep rekomandime për viruset që duhet të përfshihen në përbërjen e vaksinave trivalente dhe katërvalente për sezonin e ardhshëm. Takimi mbahet dy herë në vit, një herë për hemisferën jugore dhe një herë për hemisferën veriore.

Azhurnimi periodik i viruseve të përfshira në vaksinat e gripit është i nevojshëm që vaksinat të jenë efektive për shkak të natyrës dinamike të viruseve të gripit, duke përfshirë ato që qarkullojnë dhe infektojnë njerëzit.

OBSH rekomandon që vaksinat trivalente për përdorim në sezonin e gripit 2025/2026 në hemisferën veriore të përmbajnë:

Vaksina të bazuara në vezë

- an A/Victoria/4897/2022 (H1N1)pdm09-like virus;
- an A/Croatia/10136RV/2023 (H3N2)-like virus; dhe
- a B/Austria/1359417/2021 (B/Victoria lineage)-like virus.

Vaksina të bazuara në kultura qelizore ose baza të rekombinuara:

- an A/Wisconsin/67/2022 (H1N1)pdm09-like virus;
- an A/District of Columbia/27/2023 (H3N2)-like virus; dhe
- a B/Austria/1359417/2021 (B/Victoria lineage)-like virus.

Për vaksinat katërvalente ose rekombinante të bazuara në vezë ose kultura qelizore për përdorim në sezonin e gripit 2025/2026 në hemisferës veriore, OBSH-ja rekomandon përfshirjen e komponentit të mëposhtëm /Yamagata lineage:

a B/Phuket/3073/2013 (B/Yamagata lineage)-like virus.